

MIRELA KUMBARO

Datëlindja: 04.03.1966

Vendlindja: Tiranë

Email: Mirela.Kumbaro@parlament.al

Jetëshkrimi:

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi ka kryer studimet në vitin 1988, në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja,

Ka mbrojtur diplomën “Për përkthim dhe komunikim ndërkulturor”, në vitin 1994, në E.S.I.T – Paris III, Universiteti i Sorbonne – Nouvelle, në Paris, Francë.

Në vitin 2009 ka mbrojtur titullin “Doktor i Shkencave” në fushën e studimeve përkthimore pranë Universitetit të Tiranës. Ajo ka marrë titullin “Profesore e Asociuar” në vitin 2012, në Universitetin e Tiranës.

Në vitin 2013 emërohet Ministër i Kulturës i Republikës së Shqipërisë dhe qëndron në këtë post deri në vitin 2019. Znj. Kumbaro Furxhi nuk erdhi nga radhët e politikës, por nga një karrierë akademike dhe nga një angazhim i gjatë e aktiv në shoqërinë civile ku ka kontribuar në fushat e kulturës, arsimit dhe problemeve sociale.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, znj. Mirela Kumbaro Furxhi u zgjodh deputete e qarkut Gjirokastrë, nën siglën e Partisë Socialiste.

Znj. Kumbaro është përkthyesë, publiciste dhe eksperte ndërkombëtare për projekte ndërkulturore dhe për programe kërkimore universitare, të ndërmarra nga organizatat ndërkombëtare si Bashkimi Evropian, Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë.

Në vitin 2017 ajo u nderua me urdhrin “Oficere e Nderit në Art dhe Kulturë” nga Ministria e Kulturës dhe Komunikimit të Francës, me motivacionin për kontribut të lartë në fushën e kulturës dhe të bashkëpunimit shqiptaro-francez.

Aktualisht, znj. Kumbaro është emëruar Ministër i Turizmit dhe Mjedisit dhe është mandatuar si deputete e legjislaturës së X në Qarkun e Gjirokastrës.